



SHOQATA E GJYKATËSVE TË KOSOVËS  
UDRUŽENJE SUDIJA KOSOVE  
KOSOVA JUDGES ASSOCIACION



IPVQ  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTARSTVO PRAVD  
MINISTRY OF JUSTICE



MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTARSTVO PRAVDE  
MINISTRY OF JUSTICE

Nr. Br. No. 01-1821

Dt. 27 Shtator 2007

Nr 01/48/2007

Data/Datum/Date 27.09.07  
PRISHTINË / A

**Memorandum i Mirëkuptimit**  
në mes të

**Ministrisë së Drejtësisë**  
dhe  
**Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës**

**Preambula**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit ka për qëllim sigurimin e bashkëpunimit në mes të institucioneve nënshkruese. Me këtë rast, Ministria e Drejtësisë dhe Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës kanë shprehur interesimin e tyre për bashkëpunim më të thelluar qëllimi i të cilit do të jetë, ndër të tjerash, ofrimi i ndihmës teknike për dobi të Ministrisë së Drejtësisë në përpilimin e legjislacionit në fushën e përgjegjësisë së saj.



## Korniza e Bashkëpunimit

Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës është e vetëdijshme se Ministria e Drejtësisë është në procesin e ngritjes së kapaciteteve të saj me qëllim të:

- zhvillimit të politikave të cilat do të bëjnë të mundur përpilimin cilësor të legjislacionit dhe rritjen e transparencës në përpilimin e tij,
- përmbushjen e standardeve dhe kriterëve teknike për sa i përket legjislacionit në fushën e veprimit të saj

Ministria e Drejtësisë do të angazhoj Shoqatën e Gjyqtareve të Kosovës në përpilimin e akteve ligjore sa herë që Shoqata e Gjyqtareve të Kosovës është e gatshme të ndihmoj përpilimin e atyre akteve.

## Identifikimi i kërkesave

Ministria e Drejtësisë dhe Shoqata e Gjyqtareve të Kosovës do të punojnë së bashku në periudhën pesë vjeçare nga dita e nënshkrimit të këtij memorandumit në identifikimin e nevojave konkrete duke u bazuar në çështjet e cekura më lartë; në bazë të së cilave do të kërkohet angazhimi i Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës.

Në emër të  
Ministrit të Drejtësisë

Jonuz Salihaj  
Ministër i Drejtësisë



Në emër të  
Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës

Ymer Huruglica  
Kryetar i Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës